



8678-
03.5.25

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS SHKODËR

Nr. 941/2 Prot.

Shkodër, më 05/05 /2025

LËNDA: Kërkesë për shpallje publike

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEPARTAMENTI I ANALIZAVE DHE APOSTERIORIT
SEKTORI I MONITORIMIT TË BORXHIT

DREJTORIA E BURIMEVE MBËSHTETËSE

Adresa: Tiranë, Kashar Mëzez, Lagjia Fushë Mëzez, autostrada Tiranë-Durrës, km 1,
Qendra "Pajtoni Bussines Center", kati 5.

Bazuar në nenin 96 të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "Kodi Doganor Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe pikës 4 të nenit 162 të Ligjit Nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodit të Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë", 4. "...organi publik publikon aktin në faqen e tij të internetit dhe ..." kërkojmë shpalljen publike për;

- Vendimin Nr. 911, datë 03.04.2025 "për rikuperimin me forcë të borxhit doganor" i Degës së Doganës Shkodër ndaj shtetasit "**Dritan Hyka**" i datëlindjes **19.05.1998** me numër personal identifikimi **I50519050U** dhe adresë në: rruga "Eduard Mano", ndërtesa nr. 26, hyrja 7, apt. Nr.2, Selitë, Njësia Administrative Farkë, Bashkia Tiranë.

Ju falënderojmë për bashkëpunimin.

KRYETAR





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA DOGANËS SHKODËR

Nr. 911 Prot.

Shkodër, më 03/04/2025

V E N D I M

**Për rikuperimin me forcë të borxhit doganore ndaj debitorit
“Dritan Hyka” me numër personal identifikimi I50519050U**

Dega e Doganës Shkodër me vendimin Nr. 55, datë 05.12.2024 ka vendosur kontabilizimin dhe arkëtimin e borxhit doganor në shumën totale 50.944 lekë, për debitorin subjektin “Dritan Hyka” i datëlindjes 19.05.1998 me numër personal identifikimi I50519050U dhe adresë në: rruga “Eduard Mano”, ndërtesa nr. 26, hyrja 7, apt. Nr.2, Selitë, Njësia Administrative Farkë, Bashkia Tiranë.

Ky vendim i është komunikuar debitorit të mësipërm, me Lajmerim marrje me Nr.1846/3 dhe Kod Postar RR 722 327 595 AA i cili është kthyer me shënimin “i panjohur”.

Bazuar në nenin 162 të Ligjit Nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedures Administrative të Shqipërisë” me shkresë Nr. 1846/4prot., datë 20.12.2024 është bërë “Shpallje publike ne Degë” e Vendimit Administrativ Nr.55, datë 05.12.2024 e cila ka qëndruar e afishuar nga data 20.12.2024 deri 31.12.2024.

Bazuar në nenin 96 të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe pika 4 të nenit 162 të Ligjit Nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedures Administrative të Shqipërisë” me shkresë Nr.1846/5prot., datë 20.12.2024 dhe shkresë Nr.353/1prot., datë 03.02.2025 është bërë “Kerkese për shpallje publike ne “faqen e internetit” pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave. Me shkresë (ciklim) Nr. 2639 datë 06.02.2025 DPD konfirmon shpalljen publike në “faqen e internetit”.

Bazuar në nenin 162 të Ligjit Nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedures Administrative të Shqipërisë” me shkresat Nr. 1846/6prot., datë 20.12.2024 dhe Nr. 353prot., datë 03.02.2025 është bërë “Kërkesë për shpallje publike” në Bashkia Tiranë (Njësia Administrative Farkë) dhe me shkresë Nr. 353/2prot., datë 11.03.2025 është bërë “Kërkesë për shpallje publike” në Prefektura Tiranë për Vendimit Administrativ Nr.55, datë 05.12.2024 i Degës së Doganës Shkodër.

Me shkresë Nr. 403/1prot., datë 19.03.2025 (protokolluar me tonën Nr.353/3 datë 26.03.2025 Prefektura Tiranë konfirmon shpalljen publike me datë 19.03.2025 dhe do të qëndrojë jo më pak se 10 (dhjetë) ditë.

Me shkresë Nr. 374/1prot., datë 28.03.2025 (protokolluar me tonën Nr.353/4 datë 01.04.2025 Bashkia Tiranë (Njësia Administrative Farkë) njofton afishimin e shpalljes publike me Nr.325prot., datë 07.02.2025.

Debitorit megjithëse i ka kaluar afati ligjor i ankimimit dhe afati i ekzekutimit vullnetare, nuk ka likuiduar borxhin doganor të lindur sipas vendimit të sipërpërmendur.

Në këto kushte në bazë të vendimit sipërpërmendur të Degës Doganës Shkodër, me qëllim rikuperimin me forcë të borxhit doganor në shumën prej 50.944 lekë për debitorin subjekti “Dritan Hyka” me numër personal identifikimi I50519050U që ka ndaj Degës Doganës Shkodër, në zbatim të nenit 280 të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenit 511 e vijues të K. Pr. Civile dhe udhëzimit Nr.15 datë 03.12.2018 të Drejtorisë Përgjithshme Doganave “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”.

VENDOSA QË :

1. Të sekuestrohen vlerat monetare, kreditë, sendet me vlerë të çmuar, valutë të huaj të depozituara në një bankë, që i përkasin debitorit subjekti **“Dritan Hyka” me numër personal identifikimi I50519050U**, personave të tretë apo garantuesve që kanë detyrime ndaj debitorit.
2. Të sekuestrohen mallrat, pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme që i përkasin debitorit, personave të tretë apo garantuesve që kanë detyrime ndaj debitorit.
3. Sekuestrimi i mësipërm të kryhet deri në masën që të bëhet e mundur plotësimi i detyrimeve të mësipërme të përcaktuar në **vendimin Nr. 55, datë 05.12.2024** të Degës së Doganës Shkodër, **si dhe të kamatë vonesave të lindura** në bazë të nenit 280 pika 1/b të Kodit Doganor deri në ditën e likuidimit të borxhit doganor.
4. Pas njoftimit të këtij subjekti për *“vendimin e rikuperimit me forcë të borxhit doganor”*, subjekti juaj do të bllokohet në sistemin AË për të kryer veprime doganore.

K R Y E T A R

Aida DIZDARI

